



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KLOS

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR-MARS..

Ligji 119/2014

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01	18.01.2023	Kërkohet informacion në lidhje me organizatat OJF që kanë operuar në Bashkinë Klos.	24.01.2023	Në Bashkinë e Klosit gjatë vitit 2022 nuk ka operuar asnjë organizatë jofitimprurëse (OJF) dhe si rrjedhojë nuk ka pasur asnjë mbështetje financiare nga buxheti i bashkisë dhe as bashkëpunime.	-Me email	Nuk ka
02	10.02.2023	Kërkohet informacion i përgjithshëm në lidhje me parapërgaditjen për zgjedhjet e 14 Majit.	27.02.2023	Ministria e Punëve të Brendshme nuk e ka elokuar fondin në funksion të procesit të njoftimit me shkrim të zgjedhësve, dhe si rrjedhojë ky proces ende nuk ka nisur. Listat emërore për zgjedhjet e 14 Majit janë afishur për njohje në institucione të ndryshme në Bashkinë Klos. Në këtë proces janë angazhuar administratorët e 4 (katër) Njësive Administrative në Bashkinë e Klosit dhe kryetarët e fshatrave të cilët kanë si funksion njoftimin dhe drejtimin e qytetarëve në qendrat e tyre të votimit.	-Me postë zyrtare	Nuk ka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KLOS

03	23.02.2023	Prefekti i Qarkut Dibër kërkon informacion në lidhje me ankesën e shtetasit Ramiz Lela për dëmtimet e shkaktuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.	27.02.2023	<p>Verifikimi në banesën e shtetasit Ramiz Lela është bërë më datë 18.05.2021 nga grupi i punës dhe sipas procesverbalit të mbajtur po në këtë datë, banesa në fjalë ka dëmtime të rënda të ardhura si pasojë e rrëshqitjes masive të një sipërfaqe toke, 3 dynym bashkë me truallin e shtëpisë, shkaktuar nga reshjet e dendura të shiut 22-26 janar 2021.</p> <p>Pas konstatimit të situatës, Komisioni i Vlerësimit e ka vlerësuar dëmtimin e objektit, shkaktuar nga rrëshqitja masive e tokës, me vlerën 2,147,019 lekë dhe banesa është shpallur e pabanueshme.</p> <p>Studimi Gjeologo-Inxhenerik ka konfirmuar dëmtimet e rënda në banesë si pasojë e reshjeve të dendura dhe rrëshqitjes së tokës, duke shtuar se toka ku gjenden themelet e banesë së z. Ramiz Lela është e paqëndrueshme, dhe lëvizja e mëtejshme e tokës do të çojë në dëmtimin e plotë të objektit.</p> <p>Spektori i Emergjencave Civile pasi ka mbledhur të gjithë dokumentat e nevojshme për trajtimin e këtij rasti emergjent, ka dërguar dosjen e plotë në Prefekturën e Qarkut Dibër për miratimin e saj.</p> <p>Nga Prefektura është kërkuar të vihet në dispozicion “Leja e Ndërtimit” nga ana e Z. Ramiz Lela, dokument i cili dhe pse është kërkuar disa herë nga ana jonë, nuk është vënë në dispozicion duke penguar kështu edhe mbylljen e këtij procesi.</p>	-Me postë zyrtare	Nuk ka
----	------------	--	------------	---	----------------------	--------



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KLOS

04.	02.03.2023	Avokati i Popullit kërkon informacione në lidhje me mbetjet e hedhura në zonën e Qafë Dushkut	15.03.2023	<p>Lidhur me problematikën e mbetjeve në zonën “Qafë Dushk” në Njësinë Administrative Klos ju bëjmë me dije se Bashkia Klos ka ndërmarrë aksione konkrete, çdo të premtë të fundit të muajit, ku është pastruar zona periodikisht dhe vullnetarisht nga administrata e bashkisë.</p> <p>Siç edhe ju e parashtroni në kërkesën tuaj, si institucion nuk kemi informacione dhe të dhëna mbi individët apo subjektet tregtare që hedhin mbetjet në këtë zonë.</p> <p>Problematika në këtë zonë nuk paraqitet serioze pasi aksionet e vazhdueshme nga ana jonë kanë bërë të mundur pastrimin periodik të zonës në fjalë.</p> <p>Me urdhër të kryetarit, nr.49, datë më 27.02.2023, është ngritur komisioni për “Hartimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve” ku do të merren parasysh të gjithë zonat problematike për mbetjet në territorin e Bashkisë Klos për t’ju gjetur një zgjidhje sa më të shpejtë.</p>	-Me postë zyrtare	Nuk ka